

VENDIM
Nr. 1, datë 27.4.2015
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Xhezair Zaganjori	kryesues
Ardian Dvorani	anëtar
Ardian Nuni	anëtar
Arjana Fullani	anëtare
Evelina Qirjako	anëtare
Andi Çeliku	anëtar
Aleksandër Muskaj	anëtar
Guxim Zenelaj	anëtar
Edmond Islamaj	anëtar
Mirela Fana	anëtare
Medi Bici	anëtar
Shkëlzen Selimi	anëtar
Artan Zeneli	anëtar
Admir Thanza	anëtar
Tom Ndreca	anëtar
Artan Broci	anëtar

në seancën gjyqësore të datës 27.04.2015 morën në shqyrtim çështjen penale me nr. 52601-00364-00-2015 Akti, që u përket:

KËRKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë

I GJYKUAR: Arben Mehmeti, *përfaqësuar nga Av. Skënder Breca*

AKUZA: *Marrëdhënie seksuale me të mitura, parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 582, datë 25.03.2014, ka vendosur:

1. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Arben Bujar Mehmeti për kryerjen e veprës penale të “Marrëdhënies seksuale me të mitura”, parashikuar nga neni 100/1 i Kodit Penal.
2. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit Arben Mehmeti nga dhomat e paraburgimit, nëse nuk mbahet i arrestuar, i ndaluar apo, i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.
3. Shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të pandehurit Arben Mehmeti.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 50, datë 21.01.2015, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr. 582, datë 25.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë po asaj gjykate, me tjetër trup gjykues.

Kundër vendimit më datë 13.02.2015, ka paraqitur rekurs i pandehuri Arben Mehmeti, me anën e të cilit ka kërkuar: *Prishjen e vendimit nr. 50 datë 21.01.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 582 datë 25.03.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.*

duke parashtruar edhe shkaqet përkatëse:

Vendimi i gjykatës së apelit është në kundërshtim me ligjin sepse:

- Gjykata e Apelit Tiranë çmon se vendimi që ankimohet është i pavlefshëm për shkak se është marrë pas analizës, veç të tjerave, të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, me dëshmitarë, dhe në aktet e fashikullit nuk rezultojnë pikërisht thëniet e dëshmitarëve.

Arsyetimi i Gjykatës së Apelit Tiranë se riprodhimi audio nuk e zëvendëson procesverbalin në kuptim të nenit 115/1 është i gabuar. Po të analizojmë nenin 115/2 të Kodit të Procedurës Penale, është më se e qartë se procesverbali me dorëshkrim bëhet vetëm në rastet kur nuk është i mundur që procesverbali të

bëhet me stenotipi apo mjet tjetër teknik.

- Bazuar në udhëzimin nr. 282, datë 15.06.2012 “Për mbajtjen e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”, në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe paragrafit 7 e 8 të nenit 6 paragrafit 2, të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, ministri i Drejtësisë, janë përcaktuar rregullat e detyrueshme mbi: a) mbajtjen fjalë për fjalë të procesverbaleve të seancave gjyqësore, nëpërmjet regjistrimit audio, përmes mjeteve digjitale, në të gjitha ambientet e gjykatave ku zhvillohen seanca gjyqësore, në përputhje me nenet 77, 118 dhe 172 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenet 115 deri 122 të Kodit të Procedurës Penale dhe me çdo dispozitë tjetër procedurale në fuqi;

b) funksionimin e sistemit të regjistrimit audio; dhe c) mënyrën e ruajtjes së materialeve të këtyre regjistrimeve audio dhe përgatitjes, kur është e nevojshme, të transkripteve të tyre. Ku parashikohet se kur regjistrimi i seancës gjyqësore është i pamundur të realizohet, për shkak të defekteve në pajisje, procesverbali i seancës mbahet në një nga mënyrat e tjera të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale ose Kodi i Procedurës Civile apo çdo normë tjetër procedurale në fuqi sipas përcaktimit të kryetarit të seancës gjyqësore. Në këtë rast, në procesverbal shënohet shkaku i mbajtjes së procesverbalit në mënyrën tjetër.

Kur, gjatë seancës gjyqësore, pajisjet e regjistrimit janë ndezur, por shfaqen probleme me funksionimin e tyre/regjistrimin, sekretari lajmëron kryetarin e seancës, i cili urdhëron që të vijohet me një mënyrë tjetër të mbajtjes së procesverbalit gjyqësor.

- Ndryshe nga sa ka arsyetuar Gjykata e Apelit Tiranë në vendimin e saj objekt rekursi, që riprodhimi audio i pyetjes së dëshmitarit përbën një formë dokumentimi të veprimeve të seancës gjyqësore, e cila është në funksion të transparencës së procesit, por nuk e zëvendëson procesverbalin e seancës gjyqësore, i cili përcaktohet nga neni 115/1 i Kodit të Procedurës Penale, si i vetmi akt që dokumenton veprimet e gjykatës është i gabuar pasi është vetë udhëzimi nr. 282, datë 15.6.2012 “Për mbajtjen e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”, i cili ka sanksionuar që kur regjistrimi i seancës gjyqësore është i pamundur të realizohet, për shkak të defekteve në pajisje, procesverbali i seancës mbahet në një nga mënyrat e tjera të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale ose Kodi i Procedurës Civile apo çdo normë tjetër procedurale në fuqi sipas përcaktimit të kryetarit të seancës gjyqësore.

Nisur nga fakti se ka interpretime të ndryshme lidhur me mbajtjen e procesverbalit nëpërmjet regjistrimit audio apo audioviziv, të parashikuar në nenin 115 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nisur nga rëndësia që paraqet kjo çështje për të gjithë praktikën gjyqësore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 10.03.2015, në bazë të nenit 438/2 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur të dërgojë për shqyrtim këtë çështje në Kolegjet e Bashkuara, për unifikimin e praktikës gjyqësore.

Me anë të këtij vendimi, Kolegji Penal ka shtruar për diskutim para Kolegjeve të Bashkuara çështjen e mëposhtme:

1. Mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore, si akt për dokumentimin e veprimeve në seancë gjyqësore, nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, a duhet të konsiderohet në përputhje me nenin 115 e vijues të Kodit të Procedurës Penale?

KOLEGJET E BASHKUARA
TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Artan Zeneli dhe Evelina Qirjako; prokurorin Arqilea Koça, i cili kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 50, datë 21.01.2015 dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në gjykatën e apelit, mbrojtësin e të pandehurit av. Skënder Breca, i cili kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 50, datë 21.01.2015 dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në gjykatën e apelit; dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

I. Rrethanat e faktit

Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka ardhur për gjykim çështja penale në ngarkim të të pandehurit Arben Mehmeti, i akuzuar se ka kryer veprën penale të “Marrëdhënies seksuale me të mitura”, parashikuar nga neni 100/1 i Kodit Penal, në dëm të shtetases K.SH.

Nga procesverbali i seancës së datës 04.02.2014, ora 13:10, rezulton se janë shënuar gjeneralitetet e dëshmitares së pyetur nga gjykata, procedura e betimit të saj, por nuk janë shënuar pyetjet e bëra nga palët dhe gjykata dhe as përgjigjet (thëniet) e dëshmitares. Në të njëjtën mënyrë janë pasqyruar, në procesverbal, thëniet e dëshmitarëve të pyetur në seancat e tjera gjyqësore.

II. Procedura gjyqësore

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 582, datë 25.03.2014, ka vendosur:

Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Arben Bujar Mehmeti për kryerjen e veprës penale të “Marrëdhënies seksuale me të mitura”, parashikuar nga neni 100/1 i Kodit Penal.

2. Duke arsyetuar mbi bazën e provave shkresore dhe atyre me dëshmitarë, të marra në seancë gjyqësore, referuar kryesisht regjistrimit audio.

3. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 50, datë 21.01.2015, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr. 582, datë 25.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë po asaj gjykate, me tjetër trup gjykues.

4. *Me arsyetimin se:* “Në kuptim të nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale, dokumentimi i veprimeve bëhet me procesverbal, i cili përpilohet nga sekretari në formë të plotë ose të përmbledhur.

Kur procesverbali përpilohet në formë të përmbledhur, duhet bërë edhe riprodhimi fonografik dhe po të jenë kushtet, edhe riprodhimi audioviziv, kur është i domosdoshëm.

Sipas këtij rregullimi, procesverbali i pyetjes të dëshmitarit në seancë, duhet të përmbajë, qoftë edhe në mënyrë të përmbledhur, thëniet e dëshmitarit, dhe po të jenë kushtet, duhet bërë edhe riprodhimi audioviziv.

Në gjykimin në shkallë të parë, në procesverbalin e seancës, janë shënuar gjeneralitetet e dëshmitarëve të pyetur nga gjykata, procedurat e betimit të tyre, por nuk janë shënuar pyetjet dhe për më tepër thëniet e dëshmitarëve të pyetur në seancë.

Riprodhimi audio i pyetjes së dëshmitarit përbën një formë dokumentimi të veprimeve të seancës gjyqësore, e cila është në funksion të transparencës së procesit, por nuk e zëvendëson procesverbalin e seancës gjyqësore, i cili përcaktohet nga neni 115/1 i Kodit të Procedurës Penale, si i vetmi akt që dokumenton veprimet e gjykatë.

Gjykata e Apelit Tiranë çmon se procesverbali i cili nuk paraqet thëniet e dëshmitarëve të pyetur nga gjykata, të cilat kanë shërbyer për të si bazë e vendimit përfundimtar, nuk dokumenton veprimet e kryera nga gjykata, sipas parashikimit të nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Apelit Tiranë çmon se vendimi që ankimohet është i pavlefshëm për shkak se është marrë pas analizës, veç të tjerave, të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, me dëshmitarë, dhe në aktet e fashikullit nuk rezultojnë pikërisht thëniet e dëshmitarëve. Në këto kushte, ky vendim duhet prishur dhe çështja duhet të rigjykohet në shkallë të parë.”.

III. E drejta e zbatueshme

5. Nisur nga parashtrimi i mësipërm i rrethanave të faktit dhe i qëndrimeve të palëve në gjykim, për t'i dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara, për sa i takon njësimin të praktikës gjyqësore, në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në mjetin e rekursit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se duhet të mbahen parasysh, para së gjithash, dispozitat vijuese të Kushtetutës, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore (KEDNJ) dhe të Kodit të Procedurës Penale.

6. Neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: “*Gjatë procesit penal kushtohet të*

drejtë:

a) të vibet në dijëni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;

b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;

c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;

ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;

d) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.”

7. Neni 42/2 i Kushtetutës parashikon se: “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.

8. Në nenin 6 pika 1 të KEDNJ parashikohet se: “Neni 6 – E drejta për një proces të rregullt – Në përcaktimin e (...) çdo akuzë penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Çdo person i akuzuar për një veprë penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. Çdo i akuzuar për një veprë penale ka të drejtat minimale të mëposhtme; t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes; (...) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës. (...).

9. Kodi i Procedurës Penale, në dispozitat relevante parashikon se:

Neni 115: Procesverbal

1. Dokumentimi i veprimeve bëhet me procesverbal.

2. Procesverbal përpilohet nga sekretari i gjykatës, në formë të plotë ose të përmbledhur, me stenotipi, me mjet tjetër teknik dhe, kur mungojnë këto mjete, me dorëshkrim.

3. Kur procesverbal përpilohet në formë të përmbledhur duhet të bëhet edhe riprodhimi fonografik dhe, po të jenë kushtet, edhe riprodhimi audioviziv kur është i domosdoshëm.

Neni 116: Përmbajtja e procesverbalit

1. Procesverbal përmban tregimin e vendit, të vitit, të muajit, të ditës dhe kur është e nevojshme, edhe të orës, në të cilat ka filluar dhe është përfunduar, gjeneralitetet e personave që kanë marrë pjesë, tregimin e shkaqeve, kur dihen, mungesën e personave që duhet të marrin pjesë dhe kërkesat e paraqitura nga palët.

Neni 117: Nënshkrimi i procesverbalit

1. Procesverbal, me përjashtim të atij që mbahet në seancën gjyqësore, pasi lexohet, nënshkruhet në fund të çdo flete nga ai që e ka përpiluar, nga ai që procedon dhe nga personat që kanë marrë pjesë.

2. Kur njëri nga pjesëmarrësit nuk do ose nuk është në gjendje të nënshkruajë, bëhet vërejtje ku tregohet edhe shkaku.

Neni 118: Transkriptimi i procesverbalit të redaktuar me mjete stenotipie

1. Shiritat e shtypur me shenja stenotipie transkriptohen me shkronja të zakonshme jo më vonë se pesë ditë nga data kur janë formuar dhe lidhen me aktet bashkë me transkriptimin.

2. Kur për personin që ka shtypur shiritat ka ndalime për të bërë transkriptim, gjykata urdhëron që transkriptimi t'i besohet një personi të përshtatshëm, qoftë edhe jashtë administratës shtetërore.

Neni 119: Riprodhimi fonografik ose audioviziv

1. Riprodhimi fonografik ose audioviziv bëhet nga persona teknike, qoftë edhe jashtë administratës shtetërore nën drejtimin e sekretarit të gjykatës.

2. Kur bëhet riprodhimi fonografik, në procesverbal tregohet çasti i fillimit dhe i mbarimit të veprimeve të riprodhimit.

3. Kur riprodhimi fonografik nuk kuptohet, si provë shërben procesverbal i përpiluar në formë të

përmbledhur.

4. Regjistrimet fonografike ose audiovizive u bashkohen akteve.

Neni 120: Format e dokumentimit në raste të veçanta

1. Gjykata vendos të bëhet përpilimi i procesverbalit në formë të përmbledhur kur veprimet që duhet të pasqyrohen kanë përmbajtje të thjeshtë ose kur mungojnë mjetet mekanike të riprodhimit ose ndihmësit teknikë.

2. Kur përpilohet procesverbali në formë të përmbledhur, gjykata kujdeset që të shënohen pjesët thelbësore të deklarimeve dhe rrethanat në të cilat janë bërë.

Neni 121: Deklarimet gojore të palëve

1. Kur ligji nuk kërkon formën e shkruar të dokumentit, palët mund të bëjnë, vetë ose me anë të përfaqësuesve të posaçëm, kërkesa ose deklarime me gojë. Në këtë rast sekretari i gjykatës përpilon procesverbalin dhe regjistron deklarinimet. Procesverbalit i bashkohet, kur është rasti, prokura e posaçme.

2. Palës që e kërkon, i lëshohet me shpenzimet e veta një vërtetim ose kopja e deklarimeve të bëra.

Neni 122: Pavlefshmëria e procesverbalit

1. Procesverbali është i pavlefshëm kur ka dyshime rreth personave që kanë marrë pjesë ose kur mungon nënshkrimi i nëpunësit që e ka përpiluar.

Neni 345: Procesverbali i seancës

1. Sekretari mban procesverbalin e seancës, në të cilin tregohen:

a) vendi, data, ora e hapjes dhe e mbylljes së seancës;

b) përmbajtja e gjykatës;

c) emri dhe mbiemri i prokurorit dhe të dëmtuarit akuzues;

ç) gjeneralitetet e të pandehurit ose të dhëna të tjera personale që vlejnë për ta identifikuar, gjeneralitetet e mbrojtësve, të palëve private dhe të përfaqësuesve të tyre.

2. Menjëherë pas mbylljes së seancës, procesverbali, i nënshkruar në fund të çdo flete nga ai që e ka mbajtur, i paraqitet kryetarit për ta vistuar.

3. Procesverbali i seancës përfshihet në fashikullin për shqyrtimin gjyqësor.

Neni 346: Përmbajtja e procesverbalit

1. Procesverbali përshkruan veprimet e kryera në seancë dhe pasqyron në mënyrë të përmbledhur kërkesat dhe konkluzionet e prokurorit, të të dëmtuarit akuzues, mbrojtësve dhe përfaqësuesve të palëve private.

2. Urdhrat e dhënë me gojë nga kryetari riprodhohen tërësisht. Urdhrat e shpallura në seancë me anë të leximit i bashkohen procesverbalit.

Neni 347: Kërkesat e palëve për procesverbalin

1. Palët kanë të drejtë të kërkojnë shënimin në procesverbal të çdo deklarimi për të cilin kanë interes. Memoriet me shkrim të paraqitura nga palët, në mbështetje të kërkesave dhe konkluzioneve të tyre, i bashkohen procesverbalit.

2. Kryetari mund të urdhërojë, edhe kryesisht, që sekretari të lexojë pjesë të veçanta të procesverbalit me qëllim që të verifikojë saktësinë dhe plotësinë e tij. Mbi kërkesat për korrigjim ose shuarje, si dhe mbi ato që parashikohen në paragrafin 1, kryetari disponon me vendim.

Neni 368: Procesverbali i marrjes së provës

1. Në procesverbalin e marrjes së provës shënohen gjeneralitetet e dëshmitarëve, ekspertëve e të përkthyesve, si dhe paralajmërimi që u bëhet për të thënë të vërtetën dhe për përgjegjësinë që kanë në rast se bëjnë dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë.

2. Sekretari i gjykatës riprodhon pyetjet e bëra nga palët dhe nga kryetari, si dhe përgjigjet e personave të pyetur.

3. Kur gjykata vendos që procesverbali të mbahet në formë të përmbledhur, kontrolli për saktësinë e tij bëhet nga kryetari.

10. Udhëzimi i ministrit të Drejtësisë nr. 353, datë 03.09.2013, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishtme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”;

“Neni 2: Fusha e veprimit

Mjetet digjitale audio të regjistrimit të seancave gjyqësore përdoren për regjistrimin e seancave gjyqësore të gjyqimeve civile, administrative **dhe penale**, të zhvilluara në ambientet e gjykatave ku zhvillohen seanca gjyqësore në të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3: Sistemi i regjistrimit audio

Procesverbali audio i seancave gjyqësore përbën procesverbalin zyrtar të seancës në përputhje me nenin 118 të Kodit të Procedurës Civile, nenin 115 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 34 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

11. Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 358, datë 5.9.2013, “Për tarifat e transkriptimit të procesverbalit të seancës gjyqësore, të mbajtur me mjete të regjistrimit audio ose audioviziv”;

12. Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 359, datë 5.9.2013, “Për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore apo të veprimeve të tjera procedurale që zhvillohen jashtë seance”;

IV. Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

13. Me qëllim dhënien e përgjigjes mbi çështjen e shtruar për unifikim, si dhe në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt rekursi, Kolegjet e Bashkuara çmojnë të analizojnë, fillimisht, se çfarë nënkupton procesverbali, cilat janë llojet e mjeteve dhe format apo mënyrat e mbajtjes së tij, bazuar në nenet 115 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, për të arritur në konkluzionin nëse regjistrimi audio ose audioviziv është një prej tyre.

14. Në pjesën e parë, titulli i tretë, të kreut të parë të seksionit të tretë të Kodit të Procedurës Penale janë parashikuar dispozitat e përgjithshme mbi dokumentimin e veprimeve procedurale.

15. Një nga parimet themelore të Kodit të Procedurës Penale është ai i oralitetit, në bazë të të cilit, kur nuk parashikohet ndryshe në ligjin procedural, veprimet e gjykatës apo të palëve, që kanë të bëjnë me procesin penal, normalisht, paraqiten me gojë. Veprimtaria e dokumentimit të akteve të procesit penal bazohet në nevojën për ruajtjen, përshkrimin dhe pasqyrimin e veprimeve dhe akteve procedurale me qëllim që ato të kujtohen dhe vlerësohen, gjatë të gjitha fazave të procesit penal. Në këtë mënyrë, procesverbali shërben për fiksimin e ngjarjeve, fakteve dhe veprimeve procedurale ku do të bazohet, më pas edhe vendimmarrja e gjykatës dhe eventualisht të ushtrohet e drejta e ankimit.

16. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se veprimet procedurale të procesit penal duhet të dokumentohen, në mënyrë që të ruhen gjurmët e krijimit dhe përshkrimit të tyre, me qëllim që të sigurohet një proces gjyqësor i drejtë e i rregullt, sipas standardeve të gjithëpranuara. Në seancën gjyqësore mbahet vetëm një procesverbal, i cili mund të mbahet me anë të disa mjeteve alternative të përshtatshme, në formë të plotë ose të përmbledhur.

17. Kodi i Procedurës Penale parashikon parimin e përgjithshëm, sipas të cilit dokumentimi i veprimeve bëhet me procesverbal, i cili përpilohet nga sekretari i gjykatës, në formë të plotë ose të përmbledhur, me stenotipi, me mjet tjetër teknik, dhe kur mungojnë këto mjete, me dorëshkrim.

18. Në bazë të këtij kuadri ligjor, vërehet se Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë nuk bën një përkufizim të nocionit të ‘procesverbalit’, por përcakton karakteristikat më themelore që e përbëjnë atë. Karakteristika e parë e veprimtarisë së dokumentimit është cilësimi i subjektit procedural, që mban procesverbalin; pra, ai që e përpilon apo kujdeset për hartimin e procesverbalit, në varësi të faktit nëse mbahet apo jo në seancë gjyqësore. Procesverbali është një veprim publik që provon kryerjen e veprimeve të akteve procedurale që kanë ndodhur apo janë kryer në prani të këtij subjekti. Por që në vetvete, ky veprim nuk përbën provë të plotë e të paracaktuar. Si rrjedhojë, nga

ana e gjykatës mund të vlerësohet lirisht ajo çka është pasqyruar dhe paraqitur në këtë veprim dokumentues, si për sa i takon korrektësisë, ashtu dhe vërtetësisë së përshkrimeve të kryera në të gjatë zhvillimit të gjykimit.

19. Karakteristika e dytë është lloji i mjetit, domethënë mënyra e krijimit të procesverbalit, e cila ka rëndësi për dokumentimin e veprimeve. Kurse karakteristika e tretë është forma, që sipas ligjit do të thotë sasia e të informacionit të pasqyruar në procesverbal. Kjo karakteristikë e fundit ka varësi nga lloji i mjetit për hartimin e procesverbalit, pikërisht sepse, nisur nga lloji i mjetit të mbajtjes së procesverbalit, mund të jetë "e plotë" apo "e përmbledhur". Forma e plotë nënkupton pasqyrimin integral dhe literal të asaj që ndodh, thuhet apo kryhet në seancë gjyqësore.

20. Në këtë kuadër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë të analizojnë fillimisht çështjen nëse ligji shqiptar (shih të drejtën e zbatueshme) parashikon mjete të tjera të mbajtjes së procesverbalit, përveç asaj me dorëshkrim, që rëndom përdoret sot si një lloj mjeti për dokumentimin e veprimeve në procesin penal.

21. Në lidhje me llojin e dokumentimit të veprimeve procedurale; pra, lidhur me llojin e mjetit dokumentues, neni 115 i Kodit të Procedurës Penale parashikon tre lloje mjetesh për mbajtjen e procesverbalit kryesor, domethënë të dokumentimit të veprimeve, përkatësisht: i) procesverbali i përgatitur me mjetin e stenotipisë; ii) procesverbali i përgatitur me mjet tjetër teknik; iii) procesverbali i përgatitur me dorëshkrim. Ndërsa, për sa i përket formës së mbajtjes së procesverbalit, si një karakteristikë përcaktuese e tij, sipas nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet se procesverbali mund të hartohet: a) në formë të plotë ose b) në formë të përmbledhur. Kur procesverbali mbahet në formë të përmbledhur, parashikohet detyrimi për riprodhimin fonografik, e po të jenë kushtet, edhe riprodhimi audioviziv kur ai është i domosdoshëm.

22. Në analizë të këtij kuadri ligjor, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, nisur nga formulimi i dispozitës së parashikuar në nenin 115 të Kodit të Procedurës Penale, rezulton më se e logjikshme dhe e natyrshme, që forma e përmbledhur e procesverbalit, i referohet vetëm llojit të procesverbalit të mbajtur me mjetin e dorëshkrimit. Kjo për arsyen se, për dy llojet e para të procesverbaleve të mbajtur si mjet kryesor dokumentimi, domethënë atij të bërë me anë të mjetit të stenotipisë dhe atij të bërë me mjete të tjera teknike, duke qenë ata veçse "të plotë", nuk mund të bëhet fjalë për një përmbledhje të tyre. Kjo sepse nuk do të kishte asnjë kuptim përmbledhja e tyre, për shkak se ata përmblajnë të pasqyruar 'gjithçka' që është deklaruar apo kryer në seancë e në prani të gjykatës. Prandaj, në vlerësimin e Kolegjeve të Bashkuara, dy llojet e para të procesverbalit të mbajtur si mjet kryesor, duhet të konsiderohen vetëm (në formë) të plotë. Riprodhimi fonografik apo audioviziv (jo kryesor) në mbështetje të procesverbalit të bërë në formë të përmbledhur, bëhet (vetëm) në ato raste kur është mbajtur procesverbali me (mjetin me) shkrim, pikërisht në formë të përmbledhur. Edhe në këtë rast, ka rëndësi të theksohet se 'procesverbali' në tërësi përbëhet nga: përmbledhja me shkrim e mbajtur nga sekretari gjyqësor së bashku me riprodhimin fonografik apo audioviziv të veprimeve procedurale.

23. Bazuar në formulimin e dispozitës të sipas nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale, por nisur edhe nga parime të rëndësishme që përshkojnë ligjin procedural penal, të tillë si: parimi i oralitetit, ai i kontradiktoritetit dhe ai i gjykimit të pandërprerë, mjeti i stenotipisë është renditur duke u listuar si i pari. Kjo edhe për faktin se ai ishte një mjet mjaft i njohur për kohën kur është miratuar Kodi i Procedurës Penale. Nisur nga interpretim sistematik ky mjet për mbajtjen e procesverbalit të vetëm të seancës nuk është i vetmi. Krahas këtij mjeti, ligjvënësi jo pa qëllim ka parashikuar edhe mjete të tjera 'teknike', si alternativa kryesore për hartimin dhe mbajtjen e procesverbalit për dokumentimin e veprimeve procedurale.

24. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se për identifikimin e llojit të mjetit për mbajtjen e procesverbalit mbi dokumentimin e veprimeve – veçanërisht në seancë – duhen mbajtur parasysh: i) qëllimi i ligjvënësit, ii) evoluimi i praktikës gjyqësore në raport me arritjet e teknologjisë së informacionit, në mënyrë që të sigurohet një mjet dokumentimi, i cili të ngërthejë objektivat e zhvillimit të një gjykimi në kohë të

arsyeshme, si dhe nevojat për saktësinë, korrektësinë dhe ato të autenticitetit të paraqitjes së të dhënave në funksion të dokumentimit.

25. Në bazë të një interpretimi sistematik të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale dhe frymës së legjislacionit në fuqi, Kolegjet e Bashkuara konstatojnë se mjeti tradicional për dokumentimin e veprimeve procedurale ‘dorë-shkrimi’ është renditur si i fundit, ndër mjetet apo llojet e dokumentimit të veprimeve procedurale. Në fakt, ai është parashikuar si një përjashtim, duke u përdorur vetëm në mungesë të mjetit teknik të llojit ‘stenotipi’, si dhe në mungesë të mjeteve të tjera teknike.

26. Nisur edhe nga parimet e përgjithshme që përshkojnë fazën e shqyrtimit gjyqësor, si edhe nga fryma e dispozitave lidhur me dokumentimin e veprimeve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se përdorimi i mjetit kryesor të mbajtjes së procesverbalit me “dorëshkrim” dhe zgjedhja e formës së përmbledhur, në kushtet aktuale, kur në gjykatat shqiptare janë të instaluar aparaturat përkatëse dhe funksionon normalisht mjeti i shërbimit të regjistrimit digjital audio apo audiovideo për procesverbalin, do të pengonte realizimin e një seance gjyqësore në përputhje me parimin e oralitetit, dhe palët nuk do të kishin mundësi efektive për ndërveprimin sipas metodës dialektike procedurale.

27. Për sa i takon regjimit të mbajtjes së procesverbalit, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, në parimet e përgjithshme të tyre, parashikojnë një situatë ligjore që ka mundësi të hapur mbi llojet kryesore dhe metodologjinë e mbajtjes së procesverbalit të seancës gjyqësore. Dispozitat në fjalë parashikojnë pikënisjen nga parimi tradicional i mbajtjes me dorë të procesverbalit, për të parashikuar edhe më tej. Pra, ligjvënësi ka përcaktuar hartimin e proces-verbalit, duke filluar nga niveli mekanik (me dorë) për përpilimin e procesverbalit të seancës gjyqësore, si garancia ligjore më minimale në këtë drejtim të standardit, por jo e vetmja alternativë. Kjo garanci minimale ka qenë përdorur si më zakonisht, dhe është e lidhur me kushtet, kur u miratua Kodi i Procedurës Penale. Ky mjet, për qëllimin e dokumentimit me procesverbal, mund të gjejë zbatim në formë të plotë ose në formë të përmbledhur. Por, duke qenë një mjet i mbështetur në formatin në letër, ligjvënësi ka parashikuar një seri rregullash për nënshkrimin, datimin, dhe tregimin e elementeve të tjera, të nevojshme për t’i dhënë besueshmëri dhe autenticitet zgjedhjes së këtij mjeti tradicional të dokumentimit të veprimeve. Gjithsesi, në raport me dokumentimin e veprimeve, ligjvënësi jo pa qëllim, në nenin 115/1 të Kodit të Procedurës Penale, ka përfshirë në parashikimin ligjor edhe ‘mjete të tjera’, duke mos i përjashtuar ato nga legjitimiteti dhe nga arritjet e mëpasshme të zhvillimit të teknologjisë së avancuar digjitale. Në këtë mënyrë, ligjvënësi ka parashikuar një qasje elastike dhe të hapur edhe për ‘lloje të tjera alternative’, sa i përket krijimit dhe mbajtjes së procesverbalit të seancës, siç janë: mbajtja e procesverbalit me mjetin e stenotipisë në formë të plotë, si edhe mbajtja e procesverbalit me mjete të tjera teknike. Alternativa këto, të cilat nëse plotësojnë karakteristikat dhe qëllimin e dokumentimit, mund t’i përgjigjen në mënyrë ekuivalente kërkesave dhe nevojave për dokumentimin e praktikës gjyqësore, duke sjellë efekte cilësore dhe favorizuese për palët dhe gjykatën në procesin penal.

28. Në këtë kontekst, çmohet të vihet në pah se kur është përzgjedhur dhe procedohet me mbajtjen e procesverbalit me mjetin e dorëshkrimit dhe në formë të plotë, mjetet dhe format e tjera, në përputhje me parimin e ekonomisë gjyqësore nuk gjejnë përdorim, pasi në këtë rast, garancia është më se e plotë. Ndërsa, kur është përzgjedhur mbajtja e procesverbalit me dorëshkrim dhe në formë të përmbledhur, ligji procedural parashikon që, krahas kësaj metode, të bëhet edhe riprodhimi fonografik apo eventualisht, kur është rasti edhe ai audioviziv. Pra, në këtë rast, kur nuk është zgjedhur si formë kryesore, regjistrimi audio apo ai audiovideo, konsiderohet si një mjet riprodhimi për një veprim procedural. Kurse kur është përzgjedhur mbajtja e procesverbalit me mjetin stenotipi, i cili nuk mund të mos jetë veçse në formë të plotë, ligji procedural penal parashikon transkriptimin e plotë të shiritave të shtypur me stenotipi.

29. Ajo që ka rëndësi në përcaktimin ligjor të dispozitave procedurale është parimi i përgjithshëm se, kur zgjidhet një lloji i caktuar i dokumentimit me procesverbal, pra, si tipologji kryesore, atëherë mjetet

dhe mënyrat e tjera të dokumentimit vendosen në funksion mbështetës dhe në shërbim të plotësisht të mjetit kryesor të dokumentimit. Çka do të thotë, se kur nuk është zgjedhur si mjet kryesor, regjistrimi fonografik apo eventualisht, edhe ai audioviziv, ai shërben si mbështetës duke 'riprodhuar' përmbajtjen e procesverbalit të mbajtur me mjet kryesor. Në bazë të këtij argumentimi mund të thuhet se, kur zgjidhet si mjet kryesor teknika e regjistrimit digjital audio apo audiovideo, mënyrat e tjera të dokumentimit, siç janë shënimet apo transkriptimi, duhet të vendosen në funksion të këtij mjeti kryesor dhe të mbështesin këtë mënyrë kryesore të mbajtjes së procesverbalit.

30. Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, për nga mënyra e formulimit të nenit 115/1 të Kodit të Procedurës Penale, nuk përbën asnjë pengesë për përdorimin e regjistrimit me mjetin audio apo audiovideo - kur ekzistojnë aparaturat e instaluar në gjykatë dhe shërbimi funksionon normalisht- në zgjedhjen si mjet kryesor dhe alternativ, të atij të dokumentimit të veprimeve me anë të regjistrimit audio dhe audiovideo. Mjet ky që shërben, krahas atij të stenotipisë dhe eventualisht atij me dorëshkrim, në mbajtjen e procesverbalit të seancës.

31. Çështja që shtrohet përpara Kolegjeve të Bashkuara është nëse regjistrimet digjitale audio apo kur janë instaluar ato audiovideo, mund të konsiderohen si "mjete teknike", të cilat për nga vetitë dhe karakteristikat e tyre janë ose jo, të afta dhe në gjendje që të dokumentojnë veprimet gjatë procesit penal, e më konkretisht, veprimet procedurale si akte apo si fakte të ndodhura në seancën gjyqësore në prani të palëve pjesëmarrëse dhe të gjykatës.

32. Për të arritur në një përfundim të drejtë për sa parashtrohet, Kolegjet e Bashkuara çmojnë të vlerësojnë nëse regjistrimet digjitale audio, apo audiovideo përmbushin kriteret dhe karakteristikat që duhet të ketë një mjet teknik i aftë dhe në gjendje për dokumentimin e veprimeve. Kriteret, të cilat çmohet të jenë: besueshmëria, siguria, autenticiteti dhe integriteti i të dhënave, si dhe identifikimi i qartë pjesëmarrësve dhe përpiluesit të procesverbalit.

33. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se nga karakteristikat e këtij mjeti për hartimin e procesverbalit të seancës, i cili duke qenë i llojit digjital-zanor apo digjital-pamor dhe zanor, i kryer nën mbikëqyrjen e sekretarit gjyqësor dhe të kryesuesit të seancës, mbi të cilin edhe nëse tentohet të "ndërhyhet" mbi të, mund të dallohen pjesët e ndërhyra, faktin e ruajtjes së tij së bashku me fashikullin gjyqësor, ose në një vend tjetër publik, ai përbën një mjet efektiv për mbajtjen e procesverbalit. Funksionimi efektiv i aparatit të audio apo audiovideo regjistrimit mund të vërtetohet lehtësisht duke vëzhguar, imazhin që përvijohet në monitor nga ana e sekretarit apo e gjykatës. Prandaj, çmohet se ky mjet i përmbush kriteret e autenticitetit. Gjithashtu, nisur nga vetia e këtij mjeti për të identifikuar zërin e pjesëmarrësit në gjykim apo edhe figurën, ai mund të konsiderohet si mjet i besueshëm për dokumentim, domethënë, i aftë për paraqitjen e veprimeve dhe akteve të tjera të kryera në seancën gjyqësore, duke shfrytëzuar të gjithë potencialitetin që ky lloj mjeti mbart në vetvete, lidhur me aftësitë integrale të dokumentimit të veprimeve procedurale.

34. Për më tepër, vërehet se edhe elementet e tjera të një akti procedural, siç janë: identifikimi i palëve, tregimi i orës, i datës, i vendit, i emrit të personave pjesëmarrës dhe përmbajtja e deklarimeve të tyre, të cilat janë të domosdoshme kur zgjidhet si mjet dokumentimi ai tradicional, mund të konstatohen a të perceptohen lehtësisht përmes "dëgjimit" a "shikimit" të regjistrimit kur ai riprodhohet në mjet (suport) videodigjital apo audiodigjital që disponohet nga ana e gjykatës. Po ashtu, kur gjykata ose njëra nga palët e procesit e kërkojnë, mund të disponohet transkriptimi i atyre pjesëve relevante që kanë rëndësi për zhvillimin e procesit. Në mënyrë të ngjashme mund të thuhet edhe në rastin e mjetit dokumentues me anë të teknikës audiovideo.

35. Elementet e dokumentimit procedural janë të domosdoshëm në rastet e mbajtjes së procesverbalit me 'mjete tradicionale', por vlerësohet nuk është e domosdoshme, në rastin e mbajtjes së procesverbalit me mjetin teknik audio apo audiovideo, i cili dokumenton me tjetër mënyrë, po aq ekuivalente. Lidhja automatike e regjistrimit audio/audiovideo me shënimet e mbajtura dhe të sinkronizuara, realizohet përmes një gjurmë kohore, e cila dëshmon orën e saktë kur ngjarjet a aktet e përshkruara ndodhin në

seancën gjyqësore. Zëri i subjekteve pjesëmarrëse në një seancë regjistrohet në kanale të veçanta dhe të gjitha regjistrimet, të cilat kanë datën dhe vendin e saktë ku është zhvilluar seanca, ruhen në serverin e gjykatës. Prandaj, ashtu si të ish mbajtur me në formë të plotë e me shkrim, procesverbalit i mbajtur me mjetin e regjistrimit audio/audiovideo plotëson të gjithë elementet karakterizuese të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

36. Elementi i detyrimit të leximit sipas nenit 117 të Kodit të Procedurës Penale, vlen për hartimin e procesverbalit me mjete tradicionale. Ndërsa në rastin e mbajtjes së procesverbalit me mjetin teknik audio apo audiovideo, meqenëse kemi të bëjmë me një dokumentim-regjistrim, e jo vetëm thjesht me një përshkrim, nuk është i domosdoshëm qëndrimi i palëve dhe nënshkrimi i tij. Ndonëse jo të gjitha kërkesat formale procedurale të konceptuara për procesverbalin tradicional gjejnë zbatim për procesverbalin e mbajtur me mjet audio apo audiovideo. Në fakt, ato gjejnë zbatim gjatë transkriptimit të procesverbalit audio apo audiovideo, sepse rëndësi themelore përbën mundësia e parashikuar për disponimin e transkriptimit nga ana e gjykatës, duke përfshirë edhe gjykatën që shqyrton ankimin, apo qoftë me kërkesë paraprake të palëve, për transkriptimin e përmbajtjes së audio-verbalit apo audiovideo-verbalit.

37. Në paragrafin e parë të nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se “dokumentimi i veprimeve bëhet me procesverbal”. Sipas këtij pohimi ligjor mund të kuptohet se lloji dhe forma e procesverbalit tradicional të shkruar nuk mund të jetë dhe nuk duhet të konsiderohet si i vetmi lloj i dokumentimit të veprimeve procedurale. Domethënë ky mjet nuk është parashikuar, si e vetmja metodë për paraqitjen e akteve dhe fakteve të ndodhura në seancë gjyqësore nga ana e sekretarit gjyqësor si ‘dëshmi’ dhe ruajtje e gjurmëve rreth veprimtarisë së kryer në seancë. Ky përfundim gjen konfirmim dhe parashikohet si në nenin 346/2, ashtu edhe në nenin 368 /2 të Kodit të Procedurës Penale. Në të dy këto dispozita kërkohet shprehimisht jo vetëm pasqyrimi i përmbledhur, por riprodhimi i plotë i veprimeve procedurale apo akteve të parashikuara nga këta paragrafë, vetëm kur eventualisht, është përzgjedhur mjeti i mbajtjes së procesverbalit me dorëshkrim, kontrolli për saktësinë kryet nga kryesuesi i seancës.

38. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se edhe mundësia e regjistrimit ‘audio’ apo ‘audiovideo’, për mbajtjen e procesverbalit tashmë, mund të konsiderohen, në vetvete, si mjete teknike (elektronike) të afta për paraqitjen e akteve dhe fakteve të ndodhura në seancë gjyqësore nga ana e sekretarit gjyqësor si ‘dëshmi’ dhe ruajtje e veprimtarisë së kryer në seancë. Madje, riprodhimi i faktit apo i aktit, siç mund të jenë aktet deklarative si dëshmi apo thënie të palëve, rezulton të jetë më tepër në përputhje me efektivitetin e parimit të kontradiktoritetit dhe atij të oralitetit të sistemit procedural, sidomos në fazën e hetimit gjyqësor. Ky mjet, krahas vetive të mjetit tradicional me shkrim, pasqyron edhe ato dhëna, shprehje joverbale zanore apo pamore vështirësisht të paraqitshme me mjetin me shkrim dhe sidomos, me atë në formë të përmbledhur. Në këto kushte, përdorimi i procesverbalit mbajtur me mjetin audio apo audiovideo, do të mundësonte vlerësimin e drejtpërdrejtë dhe pa ndërmjetës të tjerë, për njohjen dhe shqyrtimin e akteve a veprimeve procedurale. Zgjedhja e këtij mjeti për mbajtjen e procesverbalit rezulton të jetë i miratuar edhe në udhëzimin e ministrit të Drejtësisë.¹

39. Mbajtja e procesverbalit me mjetin alternativ të llojit audio ose audiovideo, përveçse ka karakteristikat e atij të mbajtura me mjete tradi-cionale, pra të mjetit me shkrim apo me stenotipi, përmban edhe një karakteristikë të shtuar, e cila konsiston në regjistrimin nën kujdesjen e sekretarit të seancës dhe të kryetarit të seancës. Pra kryerja e veprimeve dhe akteve procedurale, do të mund të shqyrtohet përmes dëgjimit apo shikimit, që lejon në riprodhimin saktë e besnik të fakteve dhe akteve që kanë ndodhur në praninë e gjykatës, sikur ato të kenë ndodhur në çastin e dëgjimit apo shikimit të audio apo video-verbalit.

¹ Shin, në pjesën e të drejtës së zbatueshme të këtij Vendimi, Udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë nr. 353, datë 03.09.2013, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”.

40. Disponueshmëria e dokumentimit të veprimeve procedurale nëpërmjet regjistrimit me mjetin audio ose audiovideo, si një metodë integrale për përdorimin e saj si mjet kryesor, nisur nga karakteristikat e brendshme të tij, nënkupton që ndjekja e të gjitha rregullave të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale për metodën e procesverbalit me dorëshkrim nuk është aq rëndësishme sa që mosrespektimi i tyre të konsiderohet në rrafshin e pavlefshmërisë së procesverbalit. Kjo për arsye se shënimet dhe transkriptimet, kur regjistrimi audio apo ai audiovideo është zgjedhur si mjeti kryesor, në krijimin e procesverbalit, konsiderohen si mbështetëse të kësaj metode. Në këtë aspekt, çmohet se ky fakt i jep mundësinë gjykatës apo palëve për të lehtësuar konsultimin me përmbajtjen e audio-verbalit apo audiovideo-verbalit të seancës. Në Kodin e Procedurës Penale, pavlefshmëria e procesverbalit parashikohet në mënyrë shteruese vetëm për dy shkaqe, të cilët janë: i) kur është e pamundur të identifikohen me saktësi personat pjesëmarrës dhe ii) kur procesverbali nuk është nënshkruar nga përpiluesi i tij.

41. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se çështja që mund të shkaktojë një keqkuptim apo keqinterpretim mbi atë çka përbën procesverbal apo mbi mënyrën e mbajtjes së tij është, pikërisht nënshkrimi, i parashikuar si element, mungesa e të cilit pasjell pavlefshmëri, sipas neneve 122 dhe 345/2 të Kodit të Procedurës Penale. Kërkesa ligjore e “detyrimit për nënshkrimin”, që mund të çojë në argumentin se procesverbalet janë të pavlefshëm, kur nuk janë të nënshkruar nga personeli që i ka përpiluar ato, është e zbatueshme vetëm për procesverbalet e mbajtura me mjetin me shkrim. Prandaj, ky argumentim nuk e ndalon apo përjashton mbajtjen e procesverbalit të vetëm me mjetin alternativ të audios apo audiovideos.

42. Meqenëse neni 115 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon që procesverbali të mbahet me mjetet e disponueshme teknike, dhe duke qenë se dispozita mbi nënshkrimin i referohet vetëm procesverbalit me shkrim, atëherë mund të konkludohet se “rregulli i nënshkrimit” nuk është i zbatueshëm për regjistrimin audio apo audiovideo, dhe rrjedhimisht dispozitat e nenit 122 dhe nenit 345/2 i Kodit të Procedurës Penale, gjejnë zbatim vetëm kur procesverbali është mbajtur me shkrim. Në këto kushte, mungesa e shënimeve apo transkriptimeve kur është zgjedhur mjeti kryesor i dokumentimit të veprimeve procedurale nëpër-mjet regjistrimit audio ose audiovideo duhet të konsiderohet si një parregullsi, e cila mund të ndreqet kryesisht nga gjykata apo palët e interesuara, duke kërkuar shënimin apo transkriptimin e pjesëve relevante të verbalit audio apo audiovideo.

43. Në përgjigje të pyetjes së shtruar për unifikim, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore nëpërmjet regjistrimit audio dhe audioviziv, është jo vetëm në përputhje me nenin 115 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, por duke u parashikuar prej tij si një nga mjetet e mbajtjes së procesverbalit, rrit efektivitetin, eficiencën dhe garanton transparencën në seancat gjyqësore duke përmbyshur në mënyrë shteruese dhe autonome funksionin dokumentues të veprimeve procedurale.

44. Meqenëse Kolegjet e Bashkuara kanë çmuar si të pajtueshëm me ligjin procedural mbajtjen e procesverbalit me mjetin teknik të audios apo audiovideos, e vlerësojnë si të nevojshme të ndalen në çështjen e pasjes së mundësisë për kuptimin dhe lehtësimin e përdorimit në mënyrë efikase nga ana gjykatës të procesverbalit audio apo audiovideo. Veçanërisht kjo, në lidhje me “procesverbalin e seancës gjyqësore”, i cili përbën dhe objektin kryesor të çështjes së shtruar për unifikim, si edhe për zgjidhjen e rekursit objekt gjykimi para Kolegjeve të Bashkuara.

45. Dokumentimi i veprimeve procedurale me anë të mjetit teknik audio apo audiovideo duhet të bëhet në përputhje me parimin e procesit të rregullt në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNj-së. Kjo do të thotë se gjykata, kur e çmon të nevojshme, qoftë kryesisht, qoftë me kërkesë të palëve, përveç mundësisë së mbajtjes së shënimeve të sekretarit të sinkronizuara në procesverbalin audio apo audiovideo, duhet të disponojë sa herë që kërkohet apo e çmon të nevojshme, transkriptimin e atyre pjesëve relevante që konsiderohen si të nevojshme për qëllime të gjykimit dhe ushtrimit të drejtave ligjore që u janë njohur palëve.

46. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë, se nisur nga fakti se procesverbali i vetëm i seancës, i hartuar me

mjetin e regjistrimit audio apo video, është një mjet alternativ dhe kryesor për dokumentimin e veprimeve procedurale, mungesa e pasqyrimit apo përshkrimit të plotë të thënieve të dëshmitarit apo provave të tjera të tipit deklarativ nuk duhet të konsiderohet nga ana e gjykatës së apelit si shkak pavlefshmërie, që ndikon në prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, por në këto raste gjykata e apelit, qoftë edhe kryesisht, duhet të disponojë transkriptimin e audio verbalit apo video verbalit, me qëllim që të formojë bindjen e saj të brendshme dhe të realizojë funksionin kryesor të saj, atë të dhënies së drejtësisë.

47. Gjithashtu, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se në kushtet kur ofrohet një lloj i mbajtjes së procesverbalit të seancës gjyqësore me mjet më efektiv, mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjetin e dorëshkrimit në formë të përmbledhur, është një formë më pak efektive sesa format e plota të dokumentimit të veprimeve në seancë. Në rastet kur gjykatat e themelit do të procedojnë me hartimin e procesverbalit me mjetin e dorëshkrimit në formë të përmbledhur, ato duhet të arsyetojnë në mënyrë të detajuar rreth shkaqeve që kanë diktuar përzgjedhjen e një mjeti dokumentimi më pak efektiv sesa ai alternativ të mbajtjes së procesverbalit me llojin audio, apo audiovideo. Arsye që duhet të jenë vetëm objektive, të tilla siç mund të jenë: mungesa e mbajtjes së procesverbalit me mjetin kryesor për shkak të pamundësisë së teknologjisë, mungesa apo defektet e paparashikuara të impiantit, mungesa e energjisë elektrike, etj.

IV. Lidhur me zgjidhjen e çështjes

48. Duke iu kthyer çështjes objekt rekursi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë që ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë duke e ridërguar çështjen për rigjykim në shkallë të parë, me arsyetimin se: në gjykimin e shkallës së parë në procesverbalin e seancës nuk janë shënuar pyetjet dhe për më tepër thëniet e dëshmitarëve të pyetur në seancë, dhe se riprodhimi audio i pyetjes së dëshmitarit përbën një formë dokumentimi të veprimeve të seancës gjyqësore, e cila është në funksion të transparencës së procesit, por nuk e zëvendëson procesverbalin e seancës gjyqësore, i cili përcaktohet nga neni 115/1 i Kodit të Procedurës Penale, si i vetmi akt që dokumenton veprimet e Gjykatë, është një vendim i marrë në kundërshtim me ligjin procedural, prandaj rekursi i paraqitur nga mbrojtja e të pandehurit është i bazuar në ligj në masën dhe për arsyet e parashtruara si më sipër.

49. Ligji procedural nuk e parashikon si rast pavlefshmërie të procesverbalit mungesën e thënieve të dëshmitarit në të. Pavlefshmëria e procesverbalit është parashikuar vetëm në rastet e parashikuara në mënyrë shteruese nga neni 122 i Kodit të Procedurës Penale. Në rastin e procesverbalit të mbajtur me mjetin audio nuk mund të flitet për mungesë të thënieve të dëshmitarit, pasi procesverbali përbëhet nga zëri dhe mund të dëgjohet.

50. Në rastin konkret, meqenëse kemi të bëjmë me rastin e një dëshmitari të mitur, mbajtja e procesverbalit me mjetin alternativ të regjistrimit audio ose audiovideo, do të përbënte edhe një garanci të shtuar për mbrojtjen e interesit të të miturit, sepse do të evitonte pyetjen e tij të shpeshtë, ri-viktimizimin dhe prekjën e tij si viktimë vulnerabël.

51. Në mënyrë të ngjashme, Gjykata Europiane e Drejtësisë (Gjykata e Luksemburgut), në rastin *Pupino* C-105/032, datë 16 qershor 2005, ka përcaktuar detyrimin e shteteve anëtare të Bashkimit Europian ta interpretojnë të drejtën e tyre të brendshme procedurale penale në përputhje me të drejtën e Bashkimit Europian (vendim kuadër) dhe mbrojtjen e viktimave vulnerabël, siç janë të miturit, sa përket jetës dhe privatësisë së të miturit, duke dhënë dëshminë e tyre në përputhje me masat e marra për mbrojtjen e tyre sipas një niveli të caktuar. Edhe GjEDNj-ja në rastin *Rosin k. Estonisë*, nr. 26540/08, datë 13.12.2013, § 55, ka deklaruar si në përputhje me Konventën Evropiane faktin e përdorimit si dëshmi, të procesverbalit të regjistruar audio gjatë hetimeve paraprake të një të mituri viktimë e abuzimit seksual.

52. Në këtë mënyrë, regjistrimi audio ose audiovideo do të shmangte ri-viktimizimin si dhe ripyetjen e

² Shih: <http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=60809&pageIndex=0&doclang=EN&mode=req&dir=&occ=first&part=1&cid=603601>

të miturës më shumë se një herë pa qenë e nevojshme në apel apo edhe gjatë rigjykitimit të çështjes.

53. Për sa më sipër, vendimi i gjykatës së apelit duhet të prishet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në gjykatën e apelit me trup tjetër gjykues, i cili, duhet të shqyrtojë shkaqet e ngritura në apel në bazë të parimit të procesit të rregullt e të drejtë, duke disponuar me dëgjimin verbalit audio ku paraqiten thëniet e dëshmitarëve të pyetur nga gjykata, të cilat kanë shërbyer për të si bazë e dhënies së vendimit përfundimtar, dhe gjykimin e çështjes sipas përcaktimit të konkluzioneve dhe të frymës së këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë bazuar në nenin 438 dhe 441/ç të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSËN:

Prishjen e vendimit nr. 50, datë 21.01.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori (kryesues), Ardian Nuni, Arjana Fullani, Evelina Qirjako, Andi Çeliku, Aleksandër Muskaj, Guxim Zenelaj, Edmond Islamaj, Mirela Fana, Medi Bici, Shkëlzen Selimi, Artan Zeneli, Admir Thanza, Tom Ndreca, Artan Broci

Anëtarë kundër: Ardian Dvorani

MENDIMI I PAKICËS

1. Si gjyqtar në pakicë, në ndryshim nga shumica, kam qëndrimin se ishte vendi që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të kishin disponuar lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Shumica e Kolegjeve të Bashkuara kanë disponuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit duke e dërguar çështjen për rishqyrtim po në atë gjykatë me tjetër trupë gjykuese, në thelb, duke arsyetuar se:

2.1 Nisur nga karakteristikat që kanë, regjistrimet digjitale audio apo audiovizive konsiderohen mjet tjetër teknik në kuptim të nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale, në gjendje për dokumentimin e veprimeve dhe një mjet efektiv për mbajtjen e procesverbalit.

2.2 Ashtu si të ish mbajtur në formë të plotë dhe me shkrim, procesverbali i mbajtur me mjetin e regjistrimit audio/audiovideo plotëson të gjithë elementet karakterizuese të parashikuara nga Kodit të Procedurës Penale.

2.3 Mundësia e regjistrimit audio apo “audiovideo”, për mbajtjen e procesverbalit tashmë, mund të konsiderohen, në vetvete, si mjete teknike (elektronike) të afta për paraqitjen e akteve dhe fakteve të ndodhura në seancë gjyqësore.

2.4 Zgjedhja e këtij mjeti për mbajtjen e procesverbalit rezulton të jetë miratuar edhe në udhëzimin nr. 353 datë 03.09.2013 të ministrit të Drejtësisë.

2.5 Mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore nëpërmjet regjistrimit audio dhe audioviziv është në përputhje me nenin 115 të Kodit të Procedurës Penale, duke u parashikuar prej tij si një nga mjetet e mbajtjes së procesverbalit dhe duke përmbushur funksionin dokumentues të veprimeve procedurale.

2.6 Procesverbali i vetëm i seancës, i hartuar me mjetin e regjistrimit audio dhe video, është mjet alternativ dhe kryesor për dokumentimin e veprimeve procedurale. Mungesa e pasqyrimin të thënieve të dëshmitarit dhe provave të tjera deklarative nuk konsiderohet nga gjykata e apelit si shkak pavlefshmërie për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e apelit, qoftë edhe kryesisht, duhet të disponojë transkriptimin e audioverbalit, me qëllim formimin e bindjes së saj për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

3. Si gjyqtar në pakicë, kam mendimin se ky arsyetim është rrjedhojë e një interpretimi dhe zbatimi të gabuar të ligjit procedural penal përsa i përket kuptimit të procesverbalit të seancës gjyqësore, mënyrave të mbajtjes së tij dhe rasteve të ekzistencës e të pavlefshmërisë së këtij akti procedural, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Procesverbali si mjet i dokumentimit të veprimeve në procesin penal

4. Kodi i Procedurës Penale nuk përmban një përkufizim të shprehur lidhur me “procesverbalin”. Në doktrinë, kur flitet për formën si një aspekt të jashtëm i akteve, mund t’i referohesh si mënyrës së shfaqjes në botën e jashtme ashtu edhe mënyrës së dokumentimit. Shfaqja në botën e jashtme, që mund të jetë me gojë ose me shkrim, përbën mjetin që ka përdorur autori për të manifestuar dhe për ta bërë të njohur për të tjerët, aktin, në momentin që po realizohet.

5. Dokumentimi i një procesi bazohet në nevojën për të risjellë dhe vlerësuar, me distancë kohore, në të njëjtën shkallë ose në shkallë të tjera të gjykimit, atë që ka ndodhur në prani të subjektit që e ka mbajtur procesverbalin. Pra, dokumentimi i veprimeve, duke pasur si qëllim që të vërë në dispozicion gjurmën e asaj që ka ndodhur gjatë procesit, e destinuar për t’u ruajtur në kohë, garanton në mënyrë të veçantë mundësinë e verifikimit *a posteriori*, në rast ankimi, të vendimeve të marra më parë në kohë.

6. Përsa u përket formave të shfaqjes së akteve, në botën e jashtme, Kodi i Procedurës Penale vendos si rregull parimin e oralitetit (neni 121), që do të thotë se kur ligji nuk kërkon formën e shkruar të dokumentit, palët mund të bëjnë, vetë ose me anë të përfaqësuesve të posaçëm, kërkesa ose deklarime me gojë. Në këtë rast sekretari i gjykatës përpilon procesverbalin dhe regjistron deklaratimet. Palës që i kërkon i lëshohet me shpenzimet e veta një vërtetim ose kopja e deklaratimeve të bëra. Një rregull i tillë, në interpretim të kësaj dispozite, është parashikuar për aktet që paraqiten nga palët dhe jo për aktet e gjykatës.

7. Referuar doktrinës, procesverbali është një akt i shkruar, i përpiluar nga sekretari i gjykatës, që ka funksione pasqyruese dhe ruajtëse pasi në të riprodhohen aktet dhe faktet që janë kryer dhe kanë ndodhur në prani të përpiluesit të tij. Pra kur flasim për procesverbal, doktrina ka parasysh formën e shkruar të tij dhe kjo formë është mënyra kryesore e dokumentimit të akteve të procesit. Pozicioni superior në sistemin e mjeteve të dokumentimit, i këtij instrumenti tradicional, rezulton se konfirmohet nga rrethana që edhe *në ato raste kur Kodi i Procedurës Penale kërkon që të bëhet regjistrimi fonografik apo audioviziv këto duhet gjithmonë të shoqërohen me procesverbalin me shkrim, në mënyrë të përmbledhur*.

Mënyrat e mbajtjes së procesverbalit dhe format e tij

8. Duke konsideruar që parimet nga të cilat udhëhiqet Kodi i Procedurës Penale janë thjeshtëmi maksimal i procedimit dhe adoptimi i metodave orale, kontrolli i asaj që ka ndodhur gjatë procesit e ka bërë të nevojshme që të përdoren edhe teknika të ndryshme nga ajo e redaktimit tradicional të procesverbalit (që është ai me shkrim). Prandaj janë parashikuar mënyra plotësuese të dokumentimit, si regjistrimi fonografik e audioviziv.

9. Ligji procedural penal parashikon dy forma të dokumentimit të veprimeve në procesin penal. *Së pari*, është forma shkresore, e cila, si rregull, redaktohet me stenotipi ose mjet tjetër teknik, me parashikimin e zbatimit të mënyrës së dorëshkrimit vetëm në mungesë të këtyre mjeteve (neni 115 i Kodit të Procedurës Penale). *Së dyti*, riprodhimi fonografik dhe audioviziv. Lidhur me këtë formë, ajo e riprodhimit fonografik është i parashikuar, në mënyrë të shprehur, që të gjejë përdorim aty ku procesverbali është përpiluar në mënyrë të përmbledhur (neni 115/2), ndërsa ajo audiovizive mund të përdoret vetëm kur është e domosdoshme.

10. Përsa u takon akteve të fazës së hetimeve paraprake, në përgjithësi, në Kod parashikohet forma shkresore e tyre, si p.sh. në rastet kur duhet të bëhet njohja e personave, vendeve dhe sendeve; ballafaqimi i personave që kanë deklaruar të dhëna që kanë rëndësi për hetimin; në rastet e marrjes së provave materiale; në rastet e përgjimeve kur duhen transkriptuar bisedat e regjistruara etj, madje në disa

raste Kodi parashikon që veprimet duhen përshkruar hollësisht në procesverbal³. Ndërsa nga interpretimi i përmbajtjes së nenit 315 të Kodit të Procedurës Penale rezulton që mund të mbahen shënime, për dokumentimin e veprimeve të prokurorit, kur ekzistojnë rrethana të pakapërcyeshme që pengojnë dokumentimin aty për aty të veprimeve, pavarësisht se Kodi nuk e parashikon në mënyrë të shprehur. Por edhe në këtë rast, shënimet duhen materializuar menjëherë sapo zhduket rrethana që e pengoi, në formën e procesverbalit me shkrim.

11. *Përsa u përket mjeteve teknike për përpilimin me shkrim të procesverbalit ligji procedural penal parashikon atë të stenotipisë, nëpërmjet mjeteve të tjera teknike dhe dorëshkrimit.* Pra, Kodi të Procedurës Penale lejon dy mundësi për mbajtjen e procesverbalit: redaktimi përmes stenotipisë (që transkriptohet në shkrim ose mjeti tjetër mekanik shkrimi. Në mungesë të tyre, lejohet përpilimi i procesverbalit me anë të dorëshkrimit. Sipas kësaj dispozite i jepet përparësi përdorimit të mjetit të parë, stenotipisë ose mjetit tjetër teknik të shkrimit. Dorëshkrimi mund të përdoret vetëm në rast të pamundësisë ose mungesës së mjetit të stenotipisë ose mjeteve të tjera ekuivalente teknike.

Format e mbajtjes së procesverbalit me shkrim

12. Sipas nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale, mbajtja (përpilimi) i procesverbalit për dokumentimin e veprimeve bëhet *me shkrim*. Ndërkohë, përsa u përket mjeteve teknike për mbajtjen e procesverbalit me shkrim, ligji parashikon si mënyra, forma kryesore e parësore mjetin e stenotipisë (i cili në vetvete është edhe ky një “mjet teknik”) dhe mjete të tjera teknike të shkrimit të ndryshme nga stenotipia (si p.sh. me kompjuter, makinë shkrimi mekanike apo të tjera mënyra të shkrimit që ofron teknologjia). Si përjashtim, në mungesë ose pamundësi të përdorimit të këtyre mjeteve teknike, parashikohet mbajtja e procesverbalit me dorëshkrim, pra nëpërmjet shkrimit të aktit nga sekretari pa përdorim të mjeteve teknike.

13. Po kështu, ligji procedural parashikon dhe dallon përpilimin e *procesverbalit në formën e plotë (riprodhim) ose të përmbledhur*. Ligji i jep përparësi dhe orienton që dokumentimi i akteve dhe veprimeve, të realizohet nëpërmjet redaktimit në formën e riprodhimit (të plotë), duke lejuar përdorimin e formës së përmbledhur si përjashtim, si edhe në rastet kur norma e lejon në mënyrë të shprehur (p.sh. neni 120 i Kodit të Procedurës Penale).

14. Nga formulimi i nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale, në përmbushje të detyrimit ligjor që procesverbali të mbahet me shkrim, si mjet teknik për realizimin e këtij detyrimi është parashikuar stenotipia ose mjete të tjera teknike të shkrimit. Pra, gjykata ka mundësinë që të përdorë edhe mënyra të tjera, të cilat, aktualisht ose në të ardhmen, i ofron teknologjia për të ndihmuar dokumentimin e saktë me shkrim të akteve dhe veprimeve të procedimit. Por, sipas Kodit të Procedurës Penale këto mbeten gjithsesi vetëm mjete plotësuese dhe të pamjaftueshme, si të vetme, për të kryer, në kuptim të ligjit rolin e procesverbalit “me shkrim”, si mjeti ligjor i pa-shmangshëm për dokumentimin dhe riprodhimin e akteve, veprimeve, deklarimeve dhe thënieve që ndodhin gjatë procedimit penal.

15. Me fjalë të tjera, këto mënyra nuk mund të zëvendësojnë kërkesën e shprehur dhe të qartë të ligjit për dokumentimin “me shkrim” të proces-verbalit. Në fund të fundit, procesverbali nënkupton dokumentimin me anë të shkrimit të veprimeve dhe thënieve, pavarësisht nëse “shkrimi” realizohet me mjete teknike apo me dorëshkrim (pra pa përdorimin e këtyre mjeteve teknike). Prandaj, përveçse si një mjet plotësues dhe aspak kryesor, njësoj si riprodhimi fonografik, edhe teknologjitë e ndryshme të regjistrimit audio apo audiovideo, të cilat madje shërbejnë vetëm “për t’u përdorur me masë” e vetëm kur është e domosdoshme, mbeten mjete thjesht ndihmëse e plotësuese të dokumentimit tashmë të realizuar “me shkrim” të veprimeve në procesin penal, sikurse parashtrohet më sipër.

16. Sipas nenit 115/2 të Kodit të Procedurës Penale, mbajtja e procesverbalit në mënyrë të përmbledhur shoqërohet me riprodhimin fonografik apo atë audioviziv kur ky është i domosdoshëm. Ndërkohë, neni 120/2 parashikon raste në të cilat forma e përmbledhur e përpilimit të procesverbalit

³ Nenet 170, 171, 188, 223 të Kodit të Procedurës Penale

bëhet pa ia bashkuar detyrimisht me riprodhimet e ndryshme teknologjike: a) për dokumentimin e veprimeve që kanë përmbajtje të thjeshtë; b) kur mungojnë mjetet mekanike të riprodhimit ose ndihmësit teknikë. Në çdo rast mundësia për të zgjedhur mes formave të procesverbalit i takon gjyqtarit, duke u nisur nga nevojat e çdo rasti konkret.

17. Atëherë kur, si rregull i parashikuar nga Kodit të Procedurës Penale, për përpilimin e procesverbalit procedohet me përdorimin e mjetit teknik të stenotipisë, merren në konsideratë dy dispozita të tjera që përmbahen në titullin III, seksionin III: veçanërisht neni 118, që parashikon detyrimin e transkriptimit në shkrim të shënotave të stenotipisë jo më vonë se 5 ditë nga data kur janë formuar, si dhe neni 119 që parashikon mundësinë e riprodhimit fonografik ose audioviziv nga personat teknikë, qoftë edhe jashtë administratës shtetërore, nën drejtimin e sekretarit të gjykatës.

18. Në ato raste kur procesverbali mbahet me mjetin teknik të stenotipisë, kalimi i afatit të transkriptimit nuk sjell ndonjë pavlefshmëri procedurale, duke u parashikuar e drejta e palës që të kërkojë shënimin në procesverbal të çdo deklarimi që ka interes dhe madje të kërkojë nga kryetari i seancës që të lexojë pjesë të veçanta të procesverbalit me qëllim që të verifikojë saktësinë dhe plotësinë e tij, pra edhe përputhjen mes asaj që është transkriptuar edhe asaj që është regjistruar⁴.

19. Madje, kërkesa për transkriptimin e saktë dhe të menjëhershëm të informacionit të plotë të mbajtur me mjetin teknik të stenotipisë është tashmë një problem i zgjidhur nga teknologjia me adoptimin e sistemeve teknologjike të stenotipisë përmes lidhjes së tastierës me një kompjuter që siguron tekstin e redaktuar në karaktere të zakonshme.

20. Neni 115 i Kodit të Procedurës Penale parashikon individualizimin e dy formave të tjera të dokumentimit, të ndryshme nga ato të përshkruara në paragrafin e dytë, të konsideruara si “tipike”. Forma e parë që mbështet dokumentimin e veprimeve është ajo e parashikuar në paragrafin e tretë të këtij neni: riprodhimi fonografik. Madje ky paragraf e përcakton si rregull prezencën e përhershme të këtij mjeti teknik kur mbahet procesverbal i përmbledhur me shkrim. Bëjnë përjashtim rastet e parashikuara në nenin 120 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas doktrinės, është vetë Kodi ai që dikton një vendosje në “shkallë hierarkie”: në kuptim të nenit 119/3 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se, në fakt, procesverbali në formë të përmbledhur (me shkrim) shërben si provë vetëm atëherë kur regjistrimi fonografik nuk kuptohet, duke i dhënë kështu në rast përjashtimor më shumë besueshmëri regjistrimit me zë.

21. Forma e dytë që mbështet dokumentimin e veprimeve në kuptim të ligjit procedural penal, e parashikuar në nenin 115/3 të Kodit të Procedurës Penale, është ajo e riprodhimit audio apo audioviziv. Ky përbën një mjet jo të zakonshëm, i cili mund të përdoret vetëm në raste kur është “e domosdoshme”. Por edhe ky mjet regjistrimi e riprodhimi audioviziv i bashkohet gjithmonë procesverbalit të redaktuar në mënyrë të përmbledhur me shkrim.

22. Pra, regjistrimi fonografik ose audioviziv është një mjet që e shoqëron procesverbalin e përmbledhur me shkrim. Neni 120 i Kodit të Procedurës Penale parashikon dy situata në të cilat gjyqtari mund të disponojë me procesverbalin e përmbledhur. E para ka të bëjë me veprimet që kanë përmbajtje të thjeshtë, por në të cilën përjashtohet faza e debatimit të provave. E dyta lidhet me rastet kur mungojnë mjetet teknike të riprodhimit ose ndihmësit teknikë. Sipas doktrinės, këtu kemi të bëjmë me situata të mungesës së aparaturave të regjistrimit zanor ose të ndihmësve teknikë. Fryma e Kodit të Procedurës Penale nuk është ajo e lënies në diskrecionin e gjykatës të mbajtjes së procesverbalit përmbledhës në mungesë të aparaturave të stenotipisë, por vetëm në mungesë të disponimit të aparaturave të regjistrimit zanor. Çështja e mosdisponimit të mjeteve ose të teknikëve duhet kuptuar si prani e një pengese të përkohshme dhe të menjpërdorshme me vënien në dispozicion të mjeteve të regjistrimit fonografik me pasojën e mosaplikimit të normës për mungesa të infrastrukturës në gjykatë.

Vlera provuese e procesverbalit të seancës gjyqësore

⁴ Neni 347 i K.Pr.Penale

23. Kodi i Procedurës Penale nuk përmban ndonjë dispozitë të shprehur njësoj si përmbajtja e dispozitës së nenit 30 të Kodit të Procedurës Penale të vitit 1979, sipas të cilit përbënin provë edhe procesverbalet gjyqësore të mbajtura për çështjen penale. Ky ometim i ligjit ka sjellë debate dhe qëndrime të ndryshme në jurisprudencë në lidhje me vlerën provuese të procesverbalit sipas Kodit të Procedurës Penale në fuqi.

24. Në doktrinë ekzistojnë dy orientime të kundërta. Sipas njërit orientim, heshtja e legjislatorit ka zbehur efikasitetin provues të privilegjuar të cilin e gëzonte procesverbali sipas Kodit të Procedurës Penale të vitit 1979, duke mundësuar në këtë mënyrë që gjyqtari të vlerësojë lirisht, sipas çdo dokumenti, përmbajtjen e procesverbalit. Sipas qëndrimit tjetër doktrinor procesverbalit, dhe në përgjithësi të gjitha mjeteve të dokumentimit të përdorura në një proces penal, i atribuohet vlerë e privilegjuar, derisa nuk është deklaruar falsiteti.

25. Kam mendimin se procesverbali i seancës gjyqësore në procesin penal përbën provë të plotë për atë që përmbahet në të, për faktet që kanë ngjarë në prani të përpiluesit të procesverbalit ose për veprimet procedurale të kryera gjatë kësaj seance. Ky procesverbal duhet të jetë domosdoshmërisht i nënshkruar, nga sekretari i seancës, me pasojë pavlefshmërie sipas nenit 122 të Kodit të Procedurës Penale.

Mbajtja e procesverbalit në fazën e marrjes provave dhe debatit rreth tyre

26. Nisur nga rëndësia e tyre e posaçme, Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar rregulla të veçanta të përpilimit dhe mbajtjes së procesverbalit gjyqësor gjatë marrjes së provave dhe debatit lidhur me to. Ky Kod, për këtë moment procedural, edhe pse ndoshta jo me pasojë pavlefshmërinë, parashikon shprehimisht formën e mbajtjes së plotë, pra jo atij të përmbledhur, të procesverbalit gjyqësor, si psh për deklarimet e të pandehurit, pyetjen e dëshmitarëve, ekspertëve dhe palëve private⁵. Ndërsa kërkesat dhe pretendimet përfundimtare të prokurorit dhe të palëve pasqyrohen në procesverbal në mënyrë të përmbledhur⁶.

27. Sipas nenit 368 të Kodit të Procedurës Penale rezulton se në procesverbalin e marrjes së provës shënohen gjeneralitetet e dëshmitarëve, ekspertëve e të përkthyesve, si dhe paralajmërimi që u bëhet për të thënë të vërtetën dhe për përgjegjësinë që kanë në rast se bëjnë dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë. Pyetjet e bëra nga palët dhe kryetari si dhe përgjigjet e personave të pyetur, riprodhohen (me shkrim) nga sekretari. Pra për fazën e marrjes së provave, në veçanti të provave me dëshmitarë dhe ekspertë, Kodi ka dashur që t'i veshë procesverbalit një formë të veçantë, duke parashikuar formën e plotë (riprodhimin) të shkrimit (me stenotipi, mjet tjetër teknik apo dorëshkrim). Kjo nisur edhe nga fakti që, gjatë procesit të të provuarit, ndryshe nga procesi civil, krahas provave shkresore, në procesin penal rëndësi kryesore marrin provat me dëshmitarë, duke qenë shpesh edhe prova kyçe. Prandaj edhe pasqyrimi i saktë i tyre, në procesverbal, në mënyrë të plotë, merr rëndësi të veçantë.

28. Pra, veçanërisht në rastet e nenit 368, mbajtja e procesverbalit me shkrim, në mënyrë të plotë, përbën mënyrën e domosdoshme të dokumentimit të akteve që përpilohen në fazën e debatit të provave. Ndërsa për veprimet e tjera që ndodhin gjatë kësaj faze të hetimit gjyqësor, ato mund të pasqyrohen edhe në mënyrë të përmbledhur sipas rregullave të parashikuara në nenin 120 të Kodit të Procedurës Penale.

29. Rëndësia e procesverbalit si akt i dokumentimit të procesit, rezulton edhe nga përmbajtja e nenit 371 të Kodit të Procedurës Penale sipas të cilit procesverbalet dhe aktet që janë lexuar në seancë gjyqësore si dhe dokumentet e paraqitura nga palët e të pranuar nga gjykata, futen bashkë me *procesverbalin e seancës*, në fashikullin e gjykatës. Kjo dispozitë qartazi i referohet formës së shkresore, të plotë, të mbajtjes së procesverbalit gjyqësor.

⁵ Neni 368 i Kodit të Procedurës Penale

⁶ Neni 347 i Kodit të Procedurës Penale

Mungesa apo pavlefshmëria e procesverbalit gjyqësor

30. Bazuar në parimet dhe dispozitat në tërësi të Kodit të Procedurës Penale, gjen zbatim parimi sipas të cilit ekziston liria e zgjedhjes së formës së akteve me të cilat palët i drejtohen gjykatës, përveç rasteve kur ky Kod e lidh vlefshmërinë e aktit me një formë të caktuar. Ndërsa në rastin e akteve të gjykatës, zgjedhja e njërit apo tjetrit mjet të dokumentimit të veprimeve që kryhen në procesin penal, i përket, si rregull, gjyqtarit, por kriteret për të zgjedhur këtë mjet janë ato të diktuar nga Kodit të Procedurës Penale, si p.sh. neni 120.

31. Mbajtja e procesverbalit jo në përputhje me rregullat e vendosura në nenin 115 të Kodit të Procedurës Penale, nuk parashikohet që të passjell zbatimin e ndonjë sanksioni, as edhe pavlefshmëri të procesverbalit. Të vetmet raste të pavlefshmërisë së tij janë ato të parashikuara në nenin 122 të Kodit të Procedurës Penale, pra kur ekziston pasiguria absolute në lidhje me identitetin e personave që kanë marrë pjesë në redaktimin e aktit si dhe kur vërtetohet mungesa e nënshkrimit të nëpunësit që e ka përpiluar (sekretarit të seancës).

32. Pra, duket se nuk përbën shkak pavlefshmërie, absolute apo relative, mosrespektimi i neneve 115-120 të Kodit të Procedurës Penale, përfshirë edhe rastin e mbajtjes së procesverbalit të seancës në mënyrë të përmbledhur, duke mos pasqyruar veprimet që ndodhin në seancë, deklaratimet dhe pyetjet e palëve apo thëniet e dëshmitarëve të pyetur në seancë gjyqësore.

33. Megjithatë, është thelbësore të mbahet parasysh se, nëse nuk mbahet procesverbal me shkrim (me transkriptim nëpërmjet stenotipisë, me mjete të tjera teknike të shkrimit apo me dorëshkrim) atëherë jemi përpara gjendjes së mungesës tërësore të procesverbalit gjyqësor.

34. Riprodhimi fonografik apo riprodhimi audio ose audioviziv nuk janë procesverbal dhe as nuk janë mjet që e zëvendëson procesverbalin me shkrim. Procesverbal është akt i shkruar, me mjet teknik apo dorëshkrim. Regjistrimi dhe riprodhimi fonografik, audio, audioviziv etj. nuk janë forma të shkrimit të thënieve ose të përshkrimit të veprimeve, por janë forma të dëgjimit apo shikimit të njeriut me shqisat e tij nëpërmjet mjeteve teknologjike të këtyre thënieve dhe veprimeve. Por, Kodi i Procedurës Penale, me formulime të qarta e të shprehura të dispozitave aktuale të tij, ka parashikuar që, pavarësisht nga ekzistenca dhe përdorimi ose jo i mjeteve teknologjike të regjistrimit apo riprodhimit të seancave, thëniet dhe veprimet në procedimin penal duhet të dokumentohen me shkrim, nëpërmjet procesverbalit gjyqësor.

35. Edhe kur ligji procedural parashikon formën e mbajtjes së procesverbalit të përmbledhur, ai e parashikohet riprodhimin fonografik ose audioviziv si mjet shoqërues e plotësues të detyrueshme për efekt të dokumentimit, pra edhe vërtetësisë së thënieve dhe veprimeve që ndodhin gjatë seancës gjyqësore. Por, gjithsesi, Kodi i Procedurës Penale nuk lejon asnjë hapësirë që riprodhimi fonografik apo audio ose audioviziv të konsiderohen apo zëvendësojnë procesverbalin me shkrim, të plotë a të përmbledhur, të seancës gjyqësore.

36. Nëse procesverbal nuk gjendet në fashikullin e gjykimit, me shkrim, në formë të plotë apo të përmbledhur me elementet e përmbajtjen përkatëse sikurse e kërkon qartë apo shprehimisht ligji, atëherë, në kuptim të nenit 115 e vijues të K.Pr.Penale, këtë akt procedural nuk e përmbush a zëvendëson rregullisht as edhe mbajtja e një dokumenti shkresor, qoftë edhe të quajtur “procesverbal”, i cili vetëm synon të dokumentojë ndonjë aspekt që thjesht tregon se gjykimi ka ndodhur, e të cilit i bashkëlidhet një mjet i cili përmban regjistrimin audio apo audiovideo të seancës. Në situata të këtilla nuk kemi të bëjmë me çështje vlefshmërie apo pavlefshmërie të aktit procedural, por me mungesë, me mos ekzistencë formale juridike të dokumentimit të thënieve dhe veprimeve që kanë ndodhur gjatë procesit gjyqësor. Sipas nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale, qartazi, pa asnjë lloj dyshimi dhe alternative, parashikohet shprehimisht që dokumentimi i veprimeve bëhet me procesverbal dhe procesverbal mbahet me shkrim, me mjet teknik apo dorëshkrim. Riprodhimi fonografik, audio apo audioviziv nuk përbëjnë “dokumentim të veprimeve” në kuptim të ligjit procedural penal.

37. Si përfundim, përsa i përket njësimit të praktikës gjyqësore, si gjyqtar në pakicë kam mendimin se Kolegjet e Bashkuara duhet të kishin ardhur në përfundimin se *për dokumentimin e veprimeve në seancë gjyqësore, duhet të mbahet procesverbal, i cili është akt i shkruar, me anë të mjetit teknik të stenotipisë e të transkriptuar, me mjete të tjera teknike të shkrimit ose me dorëshkrim. Ky procesverbal me shkrim, nëse mbahet i plotë, mund të shoqërohet me riprodhim fonografik apo regjistrim audio ose audioviziv. Nëse procesverbali mbahet në formë të përmbledhur, përjashtoj rastet e nenit 120, shoqërimi me mjetin e riprodhimit fonografik apo regjistrimit audio ose audioviziv, është i detyrueshëm për gjykatën. Këto mjete nuk përbëjnë dhe as nuk qëvendësojnë procesverbalin gjyqësor, por, nëse përdoren sikurse parashtrohet më sipër, sigurojnë që konsiderohen, në këndvështrimin teknik por jo në atë juridik, si mjete plotësuuese efikase e të përshtatshme për të realizuar e ndihmuar në mënyrë të menjëhershme, të saktë dhe autentike, dokumentimin ligjor me anë të shkrimit të veprimeve që ndodhin gjatë seancës gjyqësore, si dhe tërësinë komplekse të riprodhimit të ngjarjeve, akteve apo fakteve që kanë ndodhur në seancë, duke përsëritur edhe dokumentimin e sjelljeve zanore apo pamore.*

38. Së fundi, si gjyqtar në pakicë, kam mendimin se shumica e Kolegjeve të Bashkuara ka zbatuar gabim parimet themeltare kushtetuese të fuqisë dhe shtrirjes (fushës së zbatimit) së efekteve normative të akteve nënligjore në procedimin penal. Shumica, gjatë arsytimit të qëndrimit të saj në tërësi, e veçanërisht në pikën 38, si argument të sajën për ta konsideruar të ligjshme mundësinë e mbajtjes së procesverbalit me mjetin audio, i referohet edhe zgjedhjes së këtij mjeti me udhëzimin nr. 353 datë 03.09.2013 të Ministrit të Drejtësisë “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio*”.

39. Por, ndryshe nga sa arsyeton Shumica e Kolegjeve të Bashkuara, si gjyqtar në pakicë vërej se, ky udhëzim, për nxjerrjen e tij, gjen mbështetje të shprehur ashtu sikurse e kërkon neni 118 i Kushtetutës, vetëm në paragrafin e fundit të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile ku parashikohet se: “*Procesverbali është pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore dhe ruhet për aq kohë sa edhe vetë dosja. Rregullat e hollësishme për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë*”.

40. Si gjyqtar në pakicë, kam mendimin se, *së pari*, nxjerrja e këtij akti nënligjor nuk i referohet dhe as mbështetet në ndonjë delegim që ligjvënësi t'i ketë bërë ministrit të Drejtësisë përsa i përket kryerjes së akteve procedurale dhe mbajtjes së procesverbalit në procesin penal. *Së dyti*, nxjerrja e këtij akti nënligjor i është ngarkuar MINISTRIT të Drejtësisë vetëm lidhur me procesin gjyqësor civil. *Së treti*, nxjerrja e këtij akti nënligjor i është ngarkuar Ministrit të Drejtësisë vetëm lidhur me çështjet e ruajtjes dhe arkivimit të procesverbalit gjyqësor (civil), por aspak për çështjet e mënyrës dhe formave të lejuara të mbajtjes së procesverbalit gjyqësor, me mjete audio apo të çdo forme tjetër, për shkak se këto çështje i rregullon dhe duhet ti rregullojë vetë ligji. *Së katërti*, përveç kësaj, ky udhëzim i ministrit të Drejtësisë, pa respektuar urdhërimet kushtetuese (neni 118), në pjesën hyrëse të tij, referon si mbështetje ligjore si Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurës Penale, por pa treguar dispozitën konkrete të këtyre kodeve që e ngarkon atë me kompetencën për nxjerrjen e këtij udhëzimi. Ndërkohë që delegimin e përmban vetëm paragrafi i fundit i nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile. *Së pesti*, kjo dispozitë deleguese e ngarkon ministrin e Drejtësisë që, me anë të një “urdhri”, të përcaktojë “rregulla të hollësishme” vetëm për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbaleve gjyqësore civile. Pra, nisur nga natyra përgjithësisht teknike e çështjeve të deleguara nga ligji, me anë të aktit nënligjor “urdhër” Ministri i Drejtësisë duhet të miratonte nxjerrjen e një Rregulloreje për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbaleve gjyqësore civile, ndërkohë që ai ka nxjerrë një “udhëzim” i cili është akt nënligjor i cili, për nga natyra e tij, ndjek dhe përdoret në raste e për qëllime të tjera rregullatore.

41. Duke u kthyer në çështjen objekt gjykimi, nisur nga sa arsyetohet më sipër mbi interpretimin e drejtë të ligjit të zbatueshëm, në ndryshim nga shumica, si gjyqtar në pakicë kam mendimin se Kolegjet e Bashkuara duhet të dispononin lënien në fuqi të vendimit nr. 50 datë 21.01.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin ishte prishur vendimi i gjykatës së shkallës së parë duke e dërguar çështjen për rishqyrtim po në atë gjykatë me tjetër trup gjykues. Në kushtet kur mungon procesverbali i plotë apo edhe ai i përmbledhur me përmbajtjes sikurse e kërkon shprehimisht ligji procedural penal, e duke u

zëvendësuar me të quajturin “procesverbal me mjetin audio”, gjykoj se jemi përpara mungesës së një akti procedural pa të cilin nuk mund të vërtetohet ligjërisht e rregullisht dokumentimi i thënieve dhe veprimeve që kanë ndodhur në procesin gjyqësor penal.

Anëtar: Ardian Dvorani